



Temat e Takimit:	1. Prezantimi i takimit dhe qëllimit të tij 2. Raportim nga Dom Ambroz Demaj 3. Prezantimi i faqes së internetit të projektit 4. Diskutim mbi mundësitë për pjesëmarrje dhe kontribute
Data:	23.03.2025
Ora:	18:30 – 20:30
Vendndodhja:	Online – Zoom-Meeting
Pjesëmarrësit:	Dom Ambroz Demaj, Anita Berisha, Ded Berisha, Gustin Berisha, , Laura Berisha, Mark Berisha, Nikollë Ukgjini, Petrit Gojani, Marjan Gojani, Zef Shala, Gjokë Martini, Kolë Berisha
Kryesuesi:	Kolë Berisha
Dokumentator:	Kolë Berisha

Përmbledhje e Takimit Online

1

Takimi u hap nga Kolë Berisha, i cili falënderoi pjesëmarrësit dhe donatorët. Ai përmendi Petrit Gojanin si një shembull të përkushtimit dhe angazhimit aktiv që nga fillimi i projektit. Petrit Gojani ka qenë kritik, por gjithmonë konstruktiv, duke ofruar propozime të vlefshme, të cilat, për shkak të kushteve objektive, nuk arritën të realizoheshin. Megjithatë, ai ka dhuruar 1,500 Euro, siç ishte paraparë në mbledhjet e mëparshme. Ky qëndrim i tij u lavdërua nga Kolë Berisha.

Takimi u pengua nga probleme teknike, përfshirë vonesa në hyrje të pjesëmarrësve dhe kufizime kohore në platformën Zoom. Këto vështirësi shkaktuan ndërprerje dhe pamundësuan disa pjesëmarrës që të kontribonin në diskutime. Si pasojë, nuk u arrit të shqyrtoheshin të gjitha pikat sipas planit.

Pikat Kryesore të Diskutimit:

- **Raporti mbi zhvillimin e projektit "Kisha Shën Nënë Tereza në Dugajevë":** Dom Ambroz Demaj njoftoi se ndërtimi i kishës do të nisë më 7 prill 2025 dhe dha një përmbledhje të ecurisë së projektit dhe donacioneve të mbledhura deri tani. Ai theksoi se për momentin në llogarinë e Kishës "Shën Nënë Tereza" në Dugajevë, Kosovë, janë depozituar gjithsej 26,300 Euro.
- **Donacionet:** Zefi Shala raportoi se në llogarinë e Shoqatës "Nëna Terezë" në Zvicër janë mbledhur gjithsej 14,100 Euro, duke përfshirë një donacion anonim prej 10,000 Eurosh dhe një kontribut prej 2,000 Eurosh nga Dr. Christian Ukgjini, si dhe disa donacione të tjera, emrat e të cilëve nuk u përmendën.



- **Transparenca e Fondeve:** Kolë Berisha kërkoi që të gjitha donacionet të depozitohen në llogarinë e Kishës "Shën Nënë Tereza Dugajevë" në Kosovë për të garantuar transparencë të plotë. Ai theksoi se një transparencë prej 95% nuk do të ishte e mjaftueshme dhe kërkoi një transparencë 100%. Çdo devijim mund të ngjallë dyshime dhe të krijojë pengesa për procesin e ndërtimit të kishës. Dom Ambroz Demaj sqaroi se ai ka autorizuar Zef Shalen për të depozituar fondet e mbledhura në Zvicër në llogarinë e Shoqatës "Nëna Terezë" në Zvicër, por Kolë Berisha dhe disa pjesëmarrës të tjerë kërkuan që çdo donacion të depozitohet ekskluzivisht në llogarinë e Kishës "Shën Nënë Tereza" në Kosovë.
- **Debati për Transparencën:** Një diskutim i ashpër u zhvillua për donacionin anonim. Disa pjesëmarrës, si Mark Berisha, Gustin Berisha, Marjan Gojani mbështetën kërkesën e Kolë Berishes për transparencë të plotë, ndërsa Dom Ambroz Demaj theksoi se dhuruesi anonim nuk dëshironte të identifikohet, dhe kjo duhet të respektohet.
- **Ndërprerjet dhe Vështirësitë Teknike:** Për shkak të problemeve me lidhjen në Zoom dhe nevojës për improvizime teknike me pajisjet, Kolë Berisha nuk mundi ta menaxhonte takimin siç ishte planifikuar. Disa pjesëmarrës, si Marjan Gojani, Nikollë Ukgjini dhe Gjok Martini, nuk arritën të shprehnin mendimet e tyre ashtu siç do të kishin dëshiruar.

Takimi përfundoi, megjithëse në një atmosferë të tensionuar, në mënyrë paqësore dhe konstruktive, por pa marrë një vendim të qartë dhe pa arritur konkluzione të plota.